

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Shef Grupi pranë OSSH / Drejtori Rajonale / Grup Operativ.**

SHEF GRUPI

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Koordinon dhe mbikqyr ndarjen e zonave të leximit, radhës së leximit me qëllim arritjen e eficensës së procesit të leximit.
- Koordinatori i Zonës së Shpërndarjes është përgjegjës për zbatimin e procedurave dhe rregullave të punës dhe siguron:
- Koordinimin e veprimtarisë në Tension të Mesëm me Degën e Menaxhimit të Rrjetit të Shpërndarjes në Rajon.
- Koordinimin e veprimtarisë në Tension të Ulët me Degën e Menaxhimit të Rrjetit të Shpërndarjes në Rajon.
- Koordinimin e veprimtarisë të matjes dhe leximit me Degën e Menaxhimit të Matjes dhe Leximit në Rajon.
- Koordinimin e veprimtarisë të Menaxhimit të Kohës së Punës me Degën e Shërbimeve në Rajon Koordinimin e përmbushjes brenda afateve detyrat e caktuara nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Fuqisë Punëtore dhe Urdhërave të Punës,
- Raporton te Drejtuesi Rajonit për çështjet e kontrollit të humbjeve dhe realizimin e planeve buxhetore për dhënie të informacionit të rregullt ose adhoc ;
- Koordinatori i Zonës së Shpërndarjes është përgjegjës që të:
- Sigurohet që situacionet e punimeve për veprimtarinë në Tension të Mesëm të jenë konform procedurave të Shoqërisë
- Sigurohet që situacionet e punimeve për veprimtarinë në Tension të Ulët të jenë konform procedurave të Shoqërisë
- Sigurohet për ruajtjen e materialeve dhe përdorimin e tyre bazuar në procedurat përkatëse
- Sigurohet që stafi zbaton rregullat e sigurimit teknik në punë
- Sigurohet që të realizohen planet e punës së marra sipas autorizimeve përkatëse;
- Sigurohet që të realizohet trajnimi dhe zhvillimi i aftësive të personelit;
- Kontrollon veprimtarinë duke siguruar që të gjitha veprimet janë paraqitur konform rregullave,
- Sigurohet që aktiviteti realizohet konform rregullave dhe procedurave dhe udhëzimeve të punës;
- Përcakton detyrat e të gjithë stafit nën kontrollin e tij / saj dhe duke siguruar që ato të komunikohen në mënyrë të duhur ;
- Është përgjegjës individualisht për proceset e punës me ndikim direkt përdoruesit e rrjetit me konsum të lartë në zonën e shërbimit;
- Të tjera detyra që Drejtuesi i cakton kohë pas kohe;
- Detyra Specifike të tjera:
- Kontrollon punonjësit në terren që ata ndodhen në vendin e punës dhe po realizojnë detyrat e dhëna sipas procedurave të punës

- Koordinon me grupet e mirëmbajtjes së TM/TU veprimtarinë në Terren për vijimësinë e shërbimit
- Koordinon me Zonën dhe rajonin për Veprimtarinë e O&M
- Raporton për veprimtarinë e furnizimit me energji në zonën e shërbimit
- Dërgon cdo ditë evidencën e Burimeve njerëzore të Zonës së Shërbimit në Rajon
- Propozon masa disiplinore për punonjësit që nuk realizojnë detyrat ditore.
- Përbushjen e detyrave dhe proceseve të punës që kanë ndikim direkt në rritjen e treguesve të shoqërisë.
- Reduktimi i humbjeve teknike dhe jo-teknike (komerciale).
- Ndërhjert dhe mirëmbajtjen e linjave ajrore.
- Të sigurojë një proces leximi të saktë dhe në kohë shoqëruar me foto korrekte (numri i faturave 0 dhe gabimeve në lexim)
- Të sigurojë përbushjen e detyrave të caktuara nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Fuqisë Punëtore brenda afateve.
- Zgjidhja e anomalive brenda afateve
- Leximi i saktë dhe në kohë i matësve në fiderët në TM dhe në TU.
- Të kontrollojë që realizohen nga secili punonjës:
- Të paktën 50 ndërprerje të abonentëve debitorë në shtylla (linja ajrore) ose në bokse kolektive dhe individuale në zonat e urbanizuara .
- Të paktën 25 ndërprerje të abonentëve debitorë në shtylla (linja ajrore) ose në bokse kolektive dhe individuale në zonat gjysëm të urbanizuara .
- Të paktën 20 ndërprerje të abonentëve debitorë në shtylla (linja ajrore) ose në bokse kolektive dhe individuale në zonat rurale .
- Lexime të sakta dhe në kohë për të paktën 500 abonentë ne zonat e urbanizuara.
- Lexime të sakta dhe në kohë për të paktën 200 abonentë ne zonat gjysëm të urbanizuara.
- Lexime të sakta dhe në kohë për të paktën 100 abonentë ne zonat rurale.
- Përgjegjësia për efikasitetin e faturimit % (energji e faturuar kundrejt energjisë së levruar në zonën e tij/saj të shërbimit).
- Saktësia e faturimit.
- Hedhjen në kohë të të dhënave në sistem (verifikimi i gabimeve)
- Rregjistrimi i të gjithë abonentëve dhe përditësimi i të dhënave sipas kabinave në bazën e të dhënave të abonentëve.
- Ndërprerjet dhe rilidhjet e abonentëve brenda afateve.
- Identifikimi dhe regjistrimin e abonentëve të rinj.
- Ndërprerja e debitorëve problematikë.
- Identifikimi i vjedhjeve të energjisë dhe rasteve ku është ndjekur aplikimi i dëmit ekonomik (numri i rasteve të raportuara).
- Indeksi i kënaqshmërisë në shërbime (numri i ankesave të marra në zonën e tij/saj).

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Diplomë në inxhinieri elektrike ose menaxhim energjie.
- Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet.
- Përvojë në menaxhim ekipesh dhe operacione energjitike.
- Njohuri në menaxhimin e fuqisë punëtore dhe sistemet e matjes.
- Aftësi të forta teknike dhe zgjidhje problemesh.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.